



Planuar / Doretuar Punëdhënësi / Prodator Received / Delivery	04.05.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM8HCK	2586/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.331/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1164/19 të datës 29.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.271/2019 të datës 10.05.2019 të parashtruar nga ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit me adresë:

në çështjen juridike “Ndërprerje e marrëdhënies se punës”, kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Brendshëm, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datën 04.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër Anr.271/2019 e datës 10.05.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoll 235/19 i datës 27.03.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshëm.

A r s y e t i m

Ankueses e punësuar në pozitën e punës *Nëpunëse administrative në QKRC Mitrovicë*, në Departamentin e Regjistrimit dhe Gjendjes Civile të Agjencisë së Regjistrimit Civil, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 10.05.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2232/2019 të regjistruar me numër Anr.271/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 235/19 të datës 27.03.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshëm, me të cilin vendim të njëjtës i është vërtetuar masa disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënies se punës në Shërbimin Civil” të shqiptuar nga Komisioni Disiplinor me Vendimin me numër protokoll 29/2019 të datës 15.01.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil më datë 13.05.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Ministrinë e Punëve të Brendshëm. Me datë 30.05.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshëm, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, me datë 26.08.2019 përmes njoftimit me numër protokoll 3876/2019 ka njoftuar ankuesen lidhur me pamundësinë e shqyrtimit të ankesës të datës 10.05.2019 dhe ka udhëzuar të njëjtën për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me dispozitat e Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 29.03.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.1164/2019 me të cilin ka anuluar Njoftimin e datës 26.08.2019 dhe ka obliguar Këshillin që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e parashtruar me datë 10.05.2019 nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 2232/2019 të regjistruar me numër Anr.271/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.1164/19 të datës 29.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Procesverbalin e datës 23.01.2022; Padinë e datës 11.04.2019; Njoftimin e datës 26.08.2019 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 25.01.2021; E-mailin e datës 01.03.2021; Librin e pranimit kopje nga Posta e Kosovës, për dërgesa të KPMSHCK-së të datës 27.08.2019; Vendimin e datës 26.03.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Aktvendimin PKR.nr.928/13 të datës 22.11.2018; Akt emërimin e datës 21.12.2013; Ankesën e datës 04.03.2019 parashtruar në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Autorizimin e datës 15.01.2019; Kërkesën për kthim në vendin e punës të datës 12.12.2018; Ftesën e datës 24.12.2018; Vendimin e datës 15.01.2019 të Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 11.03.2013 për pezullim parandalues nga puna me pagesë; Përgjigje në ankesë e datës 30.05.2019; Akt vendimin GJPP.nr.41/2012 të datës 26.03.2013; Kërkesën nr.1019; E-mailin e datës 27.12.2018; kopjen nga libri i pranimit 15.01.2019 dhe 11.04.2019; Procesverbalin e datës 27.02.2013; Procesverbalin e datës 15.08.2013; Procesverbalin e datës 26.02.2013; Procesverbalin e datës 20.02.2013; Procesverbalin e datës 01.03.2013, shtojcën-fotografi; Procesverbalin e datës 13.05.2013.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa Anr.271/2019 e datës 10.05.2019 e parashtruar nga ankuesja **është e pabazuar, SEPSE:**

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt emërimin me numër reference DRGJC/ARC-5/13 të datës 31.12.2013, rezulton se ankuesja ka qenë e punësuar në pozitën e punës *Nëpunëse administrative në QKRC Mitrovicë*, në Departamentin e Regjistrimit dhe Gjendjes Civile të Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Me Vendimin me numër protokoll 192/13 të datës 04.03.2013 të U.D Kryeshefit Ekzekutiv të ARC-së, ankuesja është pezulluar nga puna me pagesë 50% të pagës, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, për shkak të mbajtjes nën arrest shtëpiak dhe nën dyshimin së e njëjta ka keqpërdorur detyrën zyrtare.



Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me datë 22.11.2018 ka nxjerr Aktgjykimin PKR nr.928/13 me të cilin ka hedhur poshtë Aktakuzën PPS.nr.79/2011 të datës 29.08.2012 të Prokurorisë Speciale dhe ka pushuar procedurën penale kundër të pandehurës, tani ankueses për shkak të parashkrimit të veprës penale.

Pas hedhjes se aktakuzës, ankuesja me datë 13.12.2018 i është drejtuar me kërkesë organit të punësimit për kthim në vendin e saj të punës si *Nëpunëse administrative në QKRC Mitrovicë*. Organi i punësimit ka proceduar çështjen në Komision Disiplinor, i cili me Vendimin me numër protokolli 29/2019 të datës 15.01.2019, ndaj ankueses ka shqiptuar masën disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës".

Kundër këtij vendimi ankuesja ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshëm, ndërsa ky i fundit me Vendim me numër 235/19 të datës 27.03.2019 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses dhe ka lenë në fuqi Vendimin me numër protokolli 29/2019 të datës 15.01.2019 të Komisionit Disiplinor.

E pakënaqur me Vendimin me numër 235/19 të datës 27.03.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesja brenda fatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike pasi që sipas te njëjtës nuk është marr për bazë Aktgjykimi me numër PKR 928/13 i datës 22.11.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda me të cilin është hedhur Aktakuza PPS.nr.79/2011 e datës 29.08.2013 e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe rrjedhimisht është pushuar procedura penale kundër ankueses për shkak të veprës penale marrje e ryshfetit nga nenin 343 paragrafin 2 të KPK-së, për arsye se ka kaluar afati i parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së pretendimit ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e legjislacionit të aplikueshëm në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të ankueses, respektivisht dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht neni 1 paragrafi 1 dhe 3 ku përcaktohet se: 1. *Ky ligj rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale.* 3. *Ky ligj përcakton rregullat për menaxhimin dhe organizimin e përgjithshëm të një shërbimi civil të paanshëm politikisht, rregullat për pranimin në të, kushtet e punës, të drejtat dhe detyrimet, sjelljen personale, avancimin në karrierë, si dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civilë, si dhe nenin 83 ku përcaktohet se: "Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të pezullohet, ndërpritet dhe të përfundojë sipas kushteve të parapara me këtë ligj", dhe rrjedhimisht nga rregullimi i materies që ka përcaktuar ky ligj, Kolegji ka konstatuar se punëdhënësi mund t'i shqiptojë masën disiplinore, respektivisht t'ia ndërpresë marrëdhënien e punës nëpunësit civil nën kushtet dhe rrethanat e parashikuara me këtë Ligj.*

Me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 63 paragrafit 1 përcaktohet se: 1. *Nëpunësit civilë do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj, ndërsa me nenin 64 paragraf 1 dhe 3 përcaktohet se: 1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji.* 3. *Nëpunësit civilë të cilët tregojnë pakujdesi të rëndë në respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë analizimit të shkresave të lëndës, dhe rrjedhimisht Vendimit me numër protokoll 29/2019 të datës 15.01.2019, ka gjetur se Komisioni Disiplinor pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, pas administrimit të provave të siguruara nga Prokuroria Speciale, si Procesverbalin mbi marrjen e deklaratës së dhënë nga ankuesja me datë 27.02.2013 dhe 15.08.2013; Procesverbalin mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit H.S me datë 11.03.2013 dhe 13.03.2013; Procesverbalin mbi marrjen e deklaratës së dëshmitarit I.L me datë 20.02.2013, 26.02.2013 dhe 01.03.2018; Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit B.H, si dhe provat tjera si përgjimet telefonike të ankueses të kryera nga Policia e Kosovës, ka konstatuar se ankuesja në mënyrë permanente - vazhdueshme dhe të pa autorizuar ka komunikuar më telefon me B.H, duke ju mundësuar personave të ndryshëm rregullimin e dokumentacionit për tu pajisur me dokumente të identifikimit - udhëtimit. Komisioni Disiplinor ka konstatuar se ankueses vazhdimisht nga ana e B.H i janë premtuar të holla për rregullimin e dokumenteve të ndryshme për persona të caktuar.

Lidhur me këtë çështje Komisioni Disiplinor, me datë 20.12.2018 dhe 09.01.2019 kishte dëgjuar edhe ankuesen dhe në pyetjen e parashtruar nga komisioni se nga e njihni B.H, e njëjta kishte deklaruar se bashkëpunimi me B.H ka qenë sepse të njëjtin e ka njohur përmes vëllait të tij të cilin e ka pas në gjeneratë dhe e ka njohur edhe bashkëshorten e tij. Ndërsa lidhur me arsyet e një veprimi të tillë ankuesja kishte deklaruar se këtë e ka bërë për t'i ndihmuar qytetaret - të moshuarit.

Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor ka konstatuar se ankuesja me veprimet e saj ka bërë shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuara me nenin 63 paragrafi 1 dhe nenin 65 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.3, 1.10 dhe 1.15 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, dhe nenin 5, neni 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe neni 19 të Rregullores (QRK) Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, bazuar si me sipër dhe mbi bazën e të gjeturave nga provat e administruara të lëndës Kolegji ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Vendimit më numër 29/2019 të datës 15.01.2019 për shqiptimin e masës disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës" ndaj ankueses, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 67 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 pika 1.2.4, ku përcaktohet se: *1.Vetëm këto masa disiplinore mund të zbatohen për shkeljen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj: 1.2 për shkelje të rëndë aplikohen masat disiplinore në vijim: ... 1.2.4 ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension, pasi që ankuesja me veprimet e saj ka kryer shkelje të rënda të përcaktuara si në nenin 66 paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, 1.3, 1.10 dhe 1.15 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, dhe nenin 5 paragrafi 4 dhe nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 19 të Rregullores Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.*

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 53 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1.Nëpunësve civilë iu ndalohet që të kërkojnë ose të pranojnë nga palë të treta, për veten e tyre, bashkëshortin, familjen ose organizatat e tyre, çfarëdo favorizimi, trajtimit të veçantë, dluaratë ose shpërblim tjetër monetar ose jo monetar, ndërlidhur me parimet themelore të shërbimit civil të përcaktuara me nenin 5 paragrafi 1 nën*



paragrafët 1.1 dh 1.5 ku përcaktohet se: 1. *Nëpunësit civilë ushtrojnë detyrën në bazë të parimeve në vijim: 1.1 Ligjshmëria – Nëpunësit civilë ushtrojnë të gjitha detyrat në bazë të Kushtetutës, instrumenteve të aplikueshme ndërkombëtare si dhe legjislacionit në fuqi, 1.5 Përgjegjësia – Nëpunësit civilë janë të detyruar që të raportojnë, shpjegojnë dhe të përgjigjen për pasojat e vendimeve, veprimeve dhe mosveprimeve të tyre administrative, Kolegji njëzëri vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankueses ka përmbushur mandatin e tij ligjor që për bazë ka nenin 70 dhe 71 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.*

Rrjedhimisht, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 235/19 të datës 27.03.2019, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar dhe ka lënë në fuqi Vendimin Nr.29/19 të Komisionit Disiplinor ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, si dhe Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.331/2022

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivat të KPMSHCK-së.

